

EASPD IS THE EUROPEAN ASSOCIATION OF SERVICE PROVIDERS FOR PERSONS WITH DISABILITIES.

WE ARE A EUROPEAN NOT-FOR-PROFIT ORGANISATION AND REPRESENT OVER 15,000 SOCIAL SUPPORT SERVICE PROVIDER ORGANISATIONS ACROSS EUROPE AND DISABILITY. THE MAIN OBJECTIVE OF EASPD IS TO PROMOTE EQUAL OPPORTUNITIES FOR PEOPLE WITH DISABILITIES THROUGH EFFECTIVE AND HIGH-QUALITY SERVICE SYSTEMS.



Përkushtohu!

SIGUROJMË SHËRBIMET
MBËSHTETËSE TË SË NESËRMES!

Strategjia e EASPD-së 2018-2021

PARATHËNIE

Gjatë viteve EASPD ka krijuar një rrjet, që aktualisht përfaqëson mbi 15.000 ofrues të shërbimeve mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, në të gjithë Evropën. Shërbimet përfaqësuese mbulojnë plotësisht të gjithë ciklin jetësor të individit duke përfshirë ndërhyrjen në moshë të hershme, arsimin, punësimin, strehimin, argëtimin, formimin kulturor, përkujdesjen gjatë ditës, dhe mbështetje për moshën e tretë, dhe shërbimet mbështetëse rezidenciale.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të jetojnë një jetë të pavarur dhe autonome në një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe të gëzojnë shance dhe të drejta të barabarta, njësoj si qytetarët e tjerë. Referenca kryesore për të arritur këtë objektiv, është kuadri ligjor gjithëpërfshirës i të drejtave, të rregulluara në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, mes të tjerave, parashikojnë dhe kontekstin për zhvillimin e komuniteteve gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Shërbimet mbështetëse të bazuara në të drejtat e njeriut, mund të kontribuojnë ndjeshëm në gëzimin e të drejtave, duke promovuar aksesueshmërinë, pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen në shoqëri. Aty ku nevojiten shërbimet mbështetëse të specialistit, është me rëndësi që ata duhet të kërkojnë të jenë një hap përpara në promovimin e pavarësisë dhe të pjesëmarrjes në shoqëri të këtyre individëve. Këto shërbime duhet të dizajnohen rreth nevojave të individit, të zhvillohen, menaxhohen dhe monitorohen në një mënyrë bashkë-produktive. Kjo arrihet, përmes një ndëveprimi reciprok të individit me aftësi të kufizuara, familjarëve të tij, miqve dhe profesionistëve në mënyrë të barabartë. Kur

shërbimet bashkë-zhvillohen në këtë mënyrë, atëherë ata bëhen faktorë efektiv të ndryshimit dhe fuqizimit, dhe gjithashtu kanë një rol jetik në gjithëpërfshirjen sociale të të gjithëve.

Institucionet Evropiane dhe Pan-Evropiane, qeveritë dhe ratifikuesit e tjerë të Konventës të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e PAK, duhet të jenë koshientë për detyrimet e tyre dhe në kohë të krizave financiare – për të siguruar që të drejtat e parashikuara në këtë Konventë, të bëhen realitet për personat me aftësi të kufizuara. Duke vepruar në mënyrë të tillë, ata duhet që të angazhohen në mënyrë aktive me organizatat e shoqërisë civile dhe me aktorë të tjerë, përfshirë këtu dhe ofruesit e shërbimeve mbështetëse si ato që EASPD përfaqëson.

Shërbimet mbështetëse, qofshin ato të ofruara nga operatorë publikë apo jo-publikë, mbeten përgjegjësi e autoriteteve shtetërore për të parashikuar fonde të mjaftueshme, për të siguruar që shërbimi i ofruar është i aksesueshëm në sasi dhe cilësi, dhe efektiv për promovimin e shanceve të barabarta për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

Anëtarët e EASPD përballen me një sërë sfidash, të cilat rrjedhin nga shumëllojshmëria e kontekstit ku operojnë. Lidhja, ndarja e informacionit dhe shkëmbimi i eksperiencave me të gjitha palët e interesit në Evropë dhe përtej saj, është tejmase e rëndësishme. Ndaj EASPD dhe anëtarët e saj do të vazhdojnë të theksojnë rolin dhe vlefshmërinë e shërbimeve mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara dhe të krijojnë partneritete me aktorë të gjithanshëm, donatorë, palët kyçe të interesit dhe ofruesit lokalë, rajonalë dhe kombëtarë të shërbimeve mbështetëse.

VIZIONI

Vizioni i EASPD për të ardhmen është që çdo lloj shërbimi të jetë i personalizuar, i mundur, i aksesueshëm dhe që i përgjigjet nevojave dhe dëshirave të personave me aftësi të kufizuara.

Shërbimet mbështetëse të bazuara në të drejtat e njeriut, luajnë një rol të rëndësishëm në garantim të aksesit, pjesëmarrjes dhe gjithëpërfshirjes në shoqëri.

Ne kërkojmë që shoqëria të kuptojë plotësisht që këto shërbime mbështetëse garantojnë të drejtat e njeriut.

MISIONI

Shoqata Evropiane e ofruesëve të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara – EASPD – është një organizatë joqeveritare që përfaqëson ofruesit e shërbimeve mbështetëse në fushën e aftësisë së kufizuar, që mbulojnë spektrin e shërbimeve përgjatë gjithë ciklit të jetës.

Misioni i EASPD është që të mundësojë zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, duke mbështetur anëtarët e tij në dizajnimin, zhvillimin dhe ngritjen e modeleve mbështetëse të personalizuara, që i përgjigjen nevojave dhe dëshirave specifike. EASPD promovon ndarjen dhe zhvillimin e informacionit, inovacionit dhe punon për të influencuar mekanizmat vendimmarrës në nivel Evropian dhe ndërkombëtar.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

I. PËRFAQËSIMI

- Të jetë përfaqësuesi kyç i ofruesëve të shërbimeve mbështetëse në Evropë.

EASPD dëshiron të forcojë shërbimet mbështetëse që mbulojnë të gjithë ciklin e jetës së individit, duke siguruar pranimin e plotë të rolit të sektorit të ofruesëve të shërbimeve mbështetëse në Evropë dhe të lidhë politikat Evropiane dhe ndërkombëtare me prioritetet kombëtare dhe lokale për të promovuar gjithëpërfshirjen sociale.

SI DO TA ARRIJMË KËTË?

Ne duhet të:

- ★ Të veprojmë për të promovuar një Evropë më sociale, duke fuqizuar zbatimin e instrumentëve të të drejtave të njeriut dhe zhvillimin e kornizave ligjore që kanë impakt pozitiv në shërbimet mbështetëse.
- ★ Të mbështesim aktivisht anëtarët në përshtatjen dhe rishikimin e kornizave ligjore që janë të zbatueshme për shërbimet mbështetëse dhe punën e tyre.
- ★ Të sigurojmë qëndrueshmërinë e shërbimeve mbështetëse duke punuar me sistemet e fondeve dhe investimeve që asistojnë shërbimet mbështetëse dhe lehtësojnë inovacionin.
- ★ Të kërkojmë dhe përforcojmë përfshirjen e palëve të interesit për të vendosur një bashkëpunim të sigurtë ndërsektorial.
- ★ Të nënvizojmë çështjet e punonjësve që do të përmirësojnë interesimin ndaj sektorit dhe cilësinë e shërbimeve që ofron!

II. INOVACIONI DHE DIJA

- Të jetë në rolin e liderit dhe të organizuesit për zhvillimin e modeleve mbështetëse inovatore për personat me aftësi të kufizuara në Evropë.

EASPD do të vazhdojë të punojë mbi inovacionin social, duke identifikuar dhe kontribuar në dizejimin, zhvillimin dhe ndarjen e modeleve mbështetëse inovatore, për të përmbushur kërkesat e Konventës të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

SI DO TA ARRIJMË KËTË?

Ne duhet të:

- ★ Të integrojmë dhe fuqizojmë planifikimin me në qendër personin, bashkë-prodhimin, përfshirjen e përdoruesit dhe përshtatjen e teknologjisë, si elementë kyç të ofrimit të shërbimeve mbështetëse inovatore.
- ★ Të identifikojmë, ndajmë dhe rrisim modelet mbështetëse komunitare inovatore, përfshirë aktivitete për rritjen e kapaciteteve për të sjelle inovacion.
- ★ Të bashkëpunojë dhe kontribuojë për kërkimet akademike dhe jo-akademike, duke mbledhur të dhëna elektronike ose jo, dhe të sigurojë të dhëna të bazuara mbi gjetje, në mbështetje të zhvillimit të politikave.
- ★ Të rrisë shkëmbimet, përfshirë bashkëpunimet, me anëtarët dhe mes tyre, me autoritete lokale dhe rajonale dhe me aktorë të gjithanshëm për krijimin e bashkëpunimeve domethënëse që kanë impakt në nivel lokal.
- ★ Të jetë një qendër referimi për ndarje të dijeve dhe zhvillimit të projekteve në ofrimin e shërbimeve mbështetëse në fushën e aftësisë së kufizuar.

III. QASJA “TË UDHËHIQESH PREJ ANËTARËVE”

- EASPD do të fuqizojë proceset e saj të qeverisjes dhe idhjen e saj në fushën e sektorit social, duke qenë një organizatë e qëndrueshme që udhëhiqet prej anëtarëve të saj.

EASPD synon të arrijë pjesëmarrje më të madhe duke prezantuar qasje të reja qeverisëse. Përveç kësaj, do të merren masa të vlefshme të ndikimit të aktiviteteve dhe progresit të EASPD në zbatimin e strategjisë.

SI DO TA ARRIJMË KËTË?

Ne duhet të:

- ★ Hartojmë një strategji që përfshin zgjerimin e anëtarësimit, trajtimin e zonave gjeografike dhe sektoriale që aktualisht janë më pak të përfaqësuara në procedurat e anëtarësimit dhe menaxhimit të rrezikut për të siguruar qëndrueshmëri financiare afatgjatë.
- ★ Të rishikojmë dhe azhurnojmë proceset e qeverisjes për të siguruar përputhjen e tyre me kërkesat ligjore dhe rregullative për të siguruar zotësi më të madhe nga Bordi dhe Asambleja e Përgjithshme, si dhe për të rritur pjesëmarrjen dhe qëndrueshmërinë.
- ★ Të përforcojmë rolin e Komiteteve të Përhershme dhe Grupeve të Interesit duke i përfshirë më shumë në proceset e EASPD.
- ★ Të ndajmë informacion dhe dije me audiencën e gjerë mbi vlerën e shërbimeve mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara dhe për shoqërinë në tërësi.
- ★ Të fuqizojmë të nxënit mes anëtarëve dhe të ndajmë me ta informacion përmes platformave dhe mjeteve të komunikimit të EASPD.

KONKLUZIONE

Për të informuar zbatimin e kësaj strategjie:

- ★ Një vlerësues i jashtëm do të vlerësojë dhe raportojë mbi performancën e organizatës në përmbushjen e planit të punës për vitin 2017.
- ★ Do të zhvillohen planet vjetore të punës për çdo vit të kësaj strategjie, për të përfshirë mjete dhe tregues të qartë për të mundësuar monitorimin efektiv dhe rishikimin e progresit në baza vjetore.
- ★ Një vlerësues i jashtëm do të vlerësojë dhe raportojë për zbatimin e kësaj strategjie dhe planeve të punës.

Strategjia e ardhshme EASPD do të diskutohet gjatë vitit 2020, dhe do të finalizohet në vitin 2021.

“Kjo strategji na frymëzon të gjithëve për të krijuar shoqëri më gjithërfshirëse, duke ofruar shërbime mbështetëse të personalizuara, të një cilësie të lartë dhe që i përgjigjen nevojave. Për ta bërë këtë, ne do të vazhdojmë t’i japim sektorit zë, të ndajmë mes nesh dhe të mësojmë nga njëri - tjetri, duke u lehtësuar nga një qeverisje e shëndoshë. Së bashku me aktorët kyç dhe partnerët tanë, ne do të angazhohemi për të zbatuar vizionin tonë. Le të përkushtohemi!”



European Association of Service providers for Persons with Disabilities
Handelsstraat / Rue du Commerce 72, B-1000 Brussels
Phone: +32 2 233 77 20 | Fax: +32 2 230 72 33
Email: info@easpd.eu | Website: www.easpd.eu



Easpd Brussels



@EASPD_Brussels



EASPD



EASPD - European Association of Service providers for Persons with Disabilities



With the financial support of the European Union Programme for Employment and Social Innovation “EaSI” (2014-2020)